

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	Operatorin Ekonomik: Agronomi Group SH.P.K., Zona Industriale, Shirokë, rr. Ukë Bytyçi, p.n., - 23000, Suharekë Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	27.12.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A, paragrafi 10.1 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores **Nr. 001/2022** për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **26.12.2023**, të parashtruar nga **Operatori Ekonomik: Agronomi Group SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **HEDHET POSHTË** si e pa bazuar Kërkesa për rishqyrtim e parashtruar nga **Operatori Ekonomik: Agronomi Group SH.P.K.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: **21.12.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me hapat e më tutjeshëm për këtë aktivitetin të prokurimit
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: Agronomi Group SH.P.K. me adresë në **Suharekë**, me datë: **26.12.2023** si palë e pakënaqur ka deponuar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK Komuna e Rahovecit, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PREPARATE PËR LUFTIMIN E INSEKTIT CIKADIA E HARDHISË SË RRUSHIT – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-23-13062-1-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-068-1-2-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ - Komuna e Rahovecit, kundër Njoftimit mbi Vendim të AK-së të publikuar me **21.12.2023** në linkun <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuara, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara sipas Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes se Tenderit

Sa i përket pretendimit tuaj se *Operatori Ekonomik i rekomanduar nuk e plotëson kërkesën e lartcekur për faktin se në ofertën e tij e ka prezantuar një kontratë të lidhur me OE privat (Stonecastle Vineyards and Winery)*, mirëpo për të njëjtën nuk ka prezantuar asnjë referencë.

Pretendimi ankimor i parashtruar nga ana juaj nuk qëndron.

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë: **Gëzim Cena, Xhelal Hajda, 21000, Rahovec**, e ka plotësuar **Kërkesa me Nr. 1** të Kapaciteti teknik dhe profesional, ku ka dorëzuar Listën e Kontratave, po ashtu ka prezantuar kontratën me blerës privat (*Stonecastle Vineyards and Winery*), faturën, dëshmitë e pagesave me transaksionet bankar dhe kartelën financiare, ne përputhje me **Nenin 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**, të Ligjit për Prokurimin Publik, ku thotë: *listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;*

Ne si Autoritet Kontraktues, ne baze te Ligjit për Prokurimin Publik dhe të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ne baze te formularit **B47 Letër Standarde e kërkesës per sqarimin e tenderit**, kemi kërkuar nga Operatori Ekonomik ta na dorëzon dhe Referencë me blerësin privat (*Stonecastle Vineyards and Winery*), ku Operatori Ekonomik e ka dorëzuar këtë dokument ne baze te sqarimeve te kërkuara;

Shihe foto te bashkangjitura

STONECASTLE
VINEYARDS AND WINERY



Adresa: Rahovec - fsh. Bërnjak pa nr.

Numri i regjistrimit: 810518392

Rahovec me dt. 02.11.2023

Me kërkesë të N.T.P Agronomi me Nr.810390675 me
adrese: Rruga "Xhelal Hajfda pn.Rahovec leshojmë këtë:

Reference

Ne kuadër te realizimit per furnizim me perparate per mbrojtjen e Vreshtave si dhe inute bujqesore per vitin 2023. Kompania ynë "**StoneCastle Vineyards and Winery LLC**" ka bere furnizimin nga **N.T.P "Agronomi"** me perparate kimike per mbrojtjen e Vreshtave si dhe inute bujqesore ne vlerë prej 114.500 €. Kompania N.T.P Agronomi kete furnizim e ka realizuar shumë me sukses dhe çdo herë duke ju përmbajtur Marrëveshjes. Eshtë dalluar për profesionalizem në kryerjen e të gjitha detyrave që i janë kërkuar në lëmin e bujqësisë. Për të gjithë ata që kane nevojë per sherbime te njejta apo te ngjashme, ju kishim rekomanduar N.T.P Agronomi në Rahovec .

Me dt;02.11.2023.
Ranovec

"StoneCastle Vineyards and Winery LLC



Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit